



MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

**ANALIZË STATISTIKORE
NDIHMA JURIDIKE E GARANTUAR NGA SHTETI**

Të dhëna statistikore mbi ndihmën juridike parësore dhe dytësore

MARS 2023

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Botim i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

© Ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, rishitje, shpërndarje, kopjim, fotokopjim, përkthim, përshtatje, huapërdorje, shfrytëzim, transmetim, regjistrim, ruajtje, depozitim, përdorje dhe/ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, si dhe çdo veprim cenues me çfarëdo lloj mjete apo formë

Tabela e përmbajtjes

H Y R J E.....	3
KREU I- Të dhëna statistikore mbi çështjet me objekt ndihmën juridike parësore.....	6
Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore	6
Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara	13
Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve	21
Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga platforma Juristionline dhe Numri i Gjellbër 08001010	22
Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore	23
Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas gjinisë).....	24
Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas natyrës së çështjes)	25
Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas kategorisë përfituese).....	26
KREU 2: TË DHËNA STATISTIKORE MBI ÇËSHTJET ME OBJEKT NDIHMËN JURIDIKE DYTËSORE.....	27
Të dhëna statistikore: Kategoria Femra / Meshkuj.	27
Të dhëna statistikore: Kategoria përfituese me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme / kategori e veçantë.	27
Të dhëna statistikore: Lloji i ndihmës dytësore të ofruar.....	28
Të dhëna statistikore: Vendimi i Gjykatës / Organit procedues.	29
Të dhëna statistikore: Lloji i çështjes për të cilën kërkohet ndihmë juridike.....	30
Të dhëna statistikore: Gjykata që ka dhënë vendimin.	30
KONKLUSIONE.....	32
Sa i përket ndihmës juridike parësore.....	32
Sa i përket ndihmës juridike dytësore.....	32
Numri i vendimeve gjyqesore të ankimuara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.....	33
Ankimet e pranuar nga gjykatat e apelit (civil, administrativ) sipas juridiksionit	33
Kërkesat për ndihmë juridike dytësore të rrëzuara apo të pushuara nga gjykata	33
Kërkesa për ndreqje gabimi të depozituara në gjykatë.....	33
Kërkesa për ndreqje gabimi të pranuar nga gjykata.....	33

Numri i dosjeve avokatëve/ekspertëve të pranuar për ekzekutim pagese	33
Numri i dosjeve avokatëve/ekspertëve të refuzuara për ekzekutim pagese	33
Informacion mbi pagesat e përfaqësimit të avokatëve të ndihmës juridike dytësore si dhe shpenzimet gjyqësore të likujduara.....	34
NDIHMA JURIDIKE PARËSORE JANAR- DHJETOR 2023.....	35
NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE JANAR-DHJETOR 2023.....	36
Të dhënat statistikore për vitin 2023 (<i>Sipas kategorive të veçanta kryesore përfituese</i>).....	37

HYRJE

Qëllimi i këtij punimi është krijimi i një analize statistikore të unifikuar sa i përket sistemit të ndihmës juridike ashtu si kërkohet shprehimisht në ligjin nr. 111/2017, **“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”** dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij e cila ndikon drejtpërdrejt në hartimin dhe zbatimin e politikave të mëtejshme në fushën e ndihmës juridike falas nga Ministri i Drejtësisë.

Referuar shkronjës “d”, neni 8 i Ligjit nr.111/2017, Drejtoria e Ndihmës Juridike, mbledh dhe analizon informacionin mbi dhënien e ndihmës juridike për të përmirësuar funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike dhe organizon fushata për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përftimin e saj.

Gjithashtu, referuar shkronjës “gj”, neni 8 i Ligjit nr.111/2017, **Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas mban, mbledh, plotëson dhe administron të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve të këtij ligji dhe të dhënat e regjistrit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore, sipas rregullave dhe procedurave të miratuara nga Ministri i Drejtësisë.**

Procedura e mbajtjes, mbledhjes, plotësimit si dhe administrimit të këtyre të dhënave është e përcaktuar shprehimisht në udhëzimin nr. 1, datë 08.03.2019, **“Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”.**

Referuar këtij udhëzimi, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është organi përgjegjës për mbajtjen, mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e:

a) Të dhënave të regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti mblidhen në bazë të kërkesës për ndihmë juridike, vetëdeklarimit dhe çdo dokumentacioni tjetër të depozituar nga kërkuesi për këtë qëllim.

Në regjistrin e kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmë juridike parësore dhe dytësore, për çdo kërkues, përfshihen të dhënat e mëposhtme:

- Kërkuesi (Emri, Mbiemri);
- Gjinia,
- Datëlindja,
- Shtetësia,
- Gjendja familjare (numri i pjesëtarëve në familje),
- Gjendja e punësimit,
- Adresa dhe të dhëna të tjera kontakti,
- Gjykata/Organi procedues pranë të cilit është dorëzuar kërkesa;
- Lloji i vetëdeklarimit;
- Lloji i ndihmës detyësore të kërkuar;
- Çështje juridike;
- Vendimi i gjykatës/organit procedues mbi kërkesën për ndihmë juridike;
- Data/Nr. i vendimit;
- Ankimim i vendimit;
- Pala ankimuese;
- Vendimi mbi ankimin;
- Avokati i caktuar;
- Pagesat e përfituara nga avokati;
- Rimbursimi i pagesave.

Udhëzimi parashikon se regjistri i kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese mbahet në formë elektronike dhe bëhen publike nëpërmjet faqes elektronike të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Regjistrat me të dhënat e plota, sipas këtij udhëzimi, mbahen pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas. Të dhënat e plota të regjistrave u vihen në dispozicion institucioneve të drejtësisë dhe palëve të interesuara, pasi vlerësohet qëllimi i kërkesës dhe në përputhje me kriteret dhe kufizimet e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Punonjësi i autorizuar nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas autorizon me shkrim punonjës për plotësimin dhe përditësimin e regjistrave. Punonjësi i autorizuar është përgjegjës për saktësinë dhe përditësimin e të dhënave të hedhura prej tij.

Gjithashtu, udhëzimi parashikon se punonjësi i autorizuar nuk mund të ndërhyjë dhe të ndryshojë rubrikat e regjistrave. Në rast se bëhen gabime materiale në hedhjen e informacionit në regjistër, punonjësi i autorizuar bën korrigjimin dhe shkruan informacionin e saktë. Regjistrat administrohen nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas dhe për ruajtjen dhe asgjësimin e tyre zbatohen rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për arkivat.

KREU I- Të dhëna statistikore mbi çështjet me objekt ndihmën juridike parësore

Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore

Referuar nenit 13 të ligjit 111/2017, Ndihma juridike parësore jepet nga: ***Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore (përmes punonjësve me trajnim të posaçëm); Organizatat jofitimprurëse të autorizuara dhe Klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.***

Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore janë njësi të specializuara për dhënien e ndihmës juridike parësore. Që prej hyrjes në fuqi të ligjit nr. 111/2017, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë kanë patur për qëllim kryesor evidentimin dhe hapjen e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore në ato qytete ku shërbimi i ndihmës juridike falas (ofruar në mënyrë autonome nga ana e organizatave të ndryshme joqeveritare) ishte i mangët ose inekzistent por nga ana tjetër, edhe nevojat e qytetarëve për ndihmë juridike falas ishin të mëdha.

Aktualisht, gjatë periudhës Mars 2023, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas administron 14 (katërmëdhjetë) qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore si vijon:


- ❖ **Tiranë** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Durrës** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Lezhë** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Pogradec** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Lushnje** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Shkodër** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Gjirokastër** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Fier** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Dibër** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Vlorë** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”).
- ❖ **Elbasan** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”).
- ❖ **Berat** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”).
- ❖ **Kukës** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”).
- ❖ **Korçë** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore	Totali i Rasteve të raportuara	Moshë		Gjinia		Shtetësia		Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyra e Çështjes			Përkatësia Etnike	Kategori e veçante (Viktima Dhune)
		Mitur	Rritur	Femër	Mashkull	Shqiptar	I huaj	Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	Kategori e Veçantë	Papërcaktuar	Civile	Penale	Administrative		
Specifikime															
Tiranë	32	-	32	16	16	32	-	28	4 (aftësi e kufizuar)	-	12	2	18	-	-
Lezhë	27	-	27	9	18	27	-	21	6 (5 aftësi e kufizuar, 1 ndihmë ekonomike)	-	8	-	19	3	-
Durrës	22	-	22	18	4	22	-	20	2 (statusi i të verbrit)	-	17	-	5	-	-
Lushnje	13	-	13	7	6	13	-	7	6 (2 aftësi e kufizuar, 4 viktima dhune)	-	13	-	-	2	4
Shkodër	32	-	32	16	16	32	-	24	8 (2 ndihmë ekonomike, 2 viktima dhune, 4 KMCAP)	-	24	3	5	3	2
Gjirokastrë	43	-	43	21	22	43	-	22	21 (skema e mbrojtjes sociale)	-	11	-	32	10	-
Pogradec	27	-	27	15	12	27	-	17	10 (9 aftësi e kufizuar, 1 skema e mbrojtjes sociale)	-	11	2	14	2	-
Fier	34	-	34	15	19	34	-	28	1 (aftësi e kufizuar)	5	3	1	30	1	-
Dibër	7	-	7	-	7	7	-	4	2 (1 aftësi e kufizuar, 1 skema e mbrojtjes sociale)	1	4	1	2	-	-


Vlorë	30	-	30	19	11	30	-	22	8 (2 aftësi e kufizar, 5 skema e mbrojtjes sociale, 1 viktimë dhune)	-	9	2	19	9	1
Elbasan	20	-	20	12	8	20	-	4	16 (skema e mbrojtjes sociale)	-	11	1	8	1	-
Berat	7	-	7	5	2	7	-	7	-	-	2	-	5	-	-
Kukës	10	-	10	8	2	10	-	1	9 (2 viktimë dhune, 7 skema e mbrojtjes sociale)	-	5	-	5	-	2
Korçë	20	-	20	10	10	20	-	9	11 (10 skema e mbrojtjes sociale, 1 viktimë dhune)	-	8	-	12	2	1
TOTALI	324	-	324	171	153	324	-	214	104	6	138	12	174	32	10

Për muajin Mars 2023 janë administruar 324 raste nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore


Rastet e raportuara nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore




Rastet e raportuara nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore sipas natyrës së çështjes




Numri i rasteve të raportuara sipas gjinisë



Numri i subjekteve përfitues sipas kategorive përfituese të përcaktuara në ligj



Të dhëna specifike mbi kategoritë përfituese të ndihmës juridike parësore



Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara

Referuar nenit 15 të ligjit 111/2017, Organizatat jofitimprurëse japin shërbime të ndihmës juridike parësore në përputhje me autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë. Procedurat dhe dokumentacioni për autorizimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Procedura e dhënies të autorizimeve për periudhën 2022-2024, ka përfunduar më datë 27.09.2022, përmes lëshimit të Urdhrave të Ministrit të Drejtësisë për 15 (pesëmbëdhjetë) organizata jofitimprurëse, si vijon:

- **Forumi i Gruas Elbasan (FGE)**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Shpresa Banja. ·
- **Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA)**, Dr. Ekzekutiv: Z.Altin Hazizaj
- **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL)**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Aurela Bozo.
- **Qendra Psiko-Sociale Vatra**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Brikena Puka
- **Qendra e Gruas Hapa të Lehtë**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Denada Shpuza.
- **Qendra ALTRI**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Eda Noçka.
- **Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Iris Luarasi
- **Shoqata “Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare Berat”**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Artë Dyrmishi
- **Shoqata “Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët”**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Mariana Hereni
- **Organizata “Refleksione”**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Anthulla Ruçi.
- **Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin**, Dr. Ekzekutiv: Zj. Elona Hoxha.
- **Qendra “Konsumatori Shqiptar”**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Ersida Teliti.
- **Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara**, Dr. Ekzekutiv: Zj. Anjeza Puka.
- **Organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë”**, Dr. Ekzekutiv: Zj. Marjana Meshi.
- **Organizata “Shërbimi ligjor falas Tiranë”**, Dr. Ekzekutiv: Zj. Rajmonda Bozo.


OJF e Autorizuar	Totali i Rasteve	Mosha		Gjinia		Shtetësia			Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyra e çështjes		
		Mitur	Rritur	Femër	Mash-kull	Shqiptar	I huaj	Pa shtetësi	Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	Kategori e Veçantë	Papërcaktuar	Civile	Penale	Administrative
“Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza”	9	-	9	9	-	8	1	-	7	2 (Viktima të dhunës në familje)	-	9	-	-
“Mbrotjtja e të drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat”	6	-	6	6	0	6	-	-	-	-	6	-	-	6
“Qendra e shërbimeve dhe praktikave ligjore të integruara”	5	-	5	4	1	5	-	-	5	-	-	-	-	5
“Qendra Vatra”	20	1	19	19	1	20	-	-	-	20 (16 viktima të dhunës në familje, 3 viktima të trafikimit të qenieve njerëzore, 1 viktimë e mundshme trafikimi e mitur)	-	20	-	-
CRCA	0	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
“Forumi i Gruas Elbasan”	8	-	8	8	-	8	-	-	1	7 (2 KMCAJ)	-	8	-	-
“Shërbimi Ligjor Falas (TLAS)”	58	34	24	30	28	32	-	26	58	-	-	-	-	58

“Të ndryshëm dhe të barabartë”	19	3	16	19	-	19	-	-	1	18(13 viktima të dhunës në familje,1 viktimë e abuzuar seksualisht, 2 viktima të trafikimit të qenieve njerëzore, 3 të mitur (2 viktima të mundshme trafikimi dhe 1 i komunitetit egjiptian))	-	11	5	3
“Albanian Legal and Territorial Institute (ALTRI)”	0													
“Qendra për nisma ligjore qytetare”	23	0	23	22	1	23	-	-	9	14 (13 Viktima të dhunës në familje, 1 pensionist)	-	17	5	1
“Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët”	12	4	8	4	8	-	12	-	-	-	12	-	-	12
“Qendra Konsumatori Shqiptar”	7	-	7	1	2	-	-	-	-	-	7	-	-	7
QSHPZH	10	-	10	9	1	10	-	-	7	3 (2 të verbër, 1 pensionist)	-	-	-	10
Qendra e Gruas “Hapa të lehtë”														
Organizata “Refleksione”														
TOTAL¹	177	42	135	130	43	131	13	26	88	64	25	65	10	102


¹ 3 egjiptianë dhe romë kanë përfituar nga shërbimi i ndihmës juridike parësore nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara për muajin Mars 2023; 42 të mitur kanë përfituar nga shërbimi i ndihmës juridike parësore nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara për muajin Mars 2023;

Për muajin Mars 2023 janë administruar 177 raste nga OJF-të e autorizuara (2 ojf nuk kanë raportuar).


Numri i rasteve të raportuara nga OJF e autorizuara




Numri i rasteve të raportuara sipas natyrës së çështjes




Numri i rasteve të raportuara sipas gjinisë



Numri i subjekteve përfitues sipas kategorive të përcaktuara në ligj



Të dhëna specifike mbi kategoritë përfituese të ndihmës juridike parësore



Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve

Një ndër ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore janë edhe **Klinikat e Ligjit**. Bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 111/2017, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas bashkëpunon me klinikat ligjore, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore

Aktualisht Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka lidhur marrëveshje me 12 Institucione të Arsimit të Lartë, në Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Vlorë, konkretisht:

1. Fakulteti i Drejtësisë;
2. Kolegji Universitar “Wisdom”;
3. Klinika e Ligjit Shkodër;
4. Universiteti “Aleksandër Mojsiu” Durrës;
5. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë;
6. “Universiteti European i Tiranës”;
7. “Universiteti “Qirjazi”
8. Universiteti “Bedër”
9. Universiteti “Mesdhetar”
10. Universiteti “Marin Barleti”
11. Universiteti “Luarasi”
12. Universiteti “Epoka”.

Referuar nenit 7 të marrëveshjeve Tip të bashkëpunimit: Klinikat Ligjore do të dëgojnë të dhëna periodike çdo muaj pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas mbi personat të cilët kanë aplikuar/përfutuar ndihmë juridike parësore. Të dhënat do të dërgohen brenda 5(pesë) ditëve të para të muajit pasardhës të muajit referues. Këto institucione kanë vendosur në dispozicion të qytetarëve zyra të brendshme të përshtatshme për pritjen e klientëve, të aksesueshme edhe nga persona me aftësi të kufizuara. Klinikat, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit do të ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike parësore sipas standardeve të përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë dhe së bashku me qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe organizatat jofitimprurëse të autorizuara do të ofrojnë ndihmë juridike parësore falas për çdo subjekt përfitues sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017.

Për muajin Mars 2023 janë administruar 14 raste nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve, të raportuara nga Universiteti “Bedër”

Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga platforma Juristionline dhe Numri i Gjelbër 08001010

Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas, ka mundësuar për të gjithë qytetarët ofrimin e shërbimeve ligjore online përmes **platformës juristionline.al**. Përmes kësaj platforme çdo qytetar ka mundësi të këshillohet dhe informohet lidhur me aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor, dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore.

Pyetjet e dërguara në këtë platformë, që nga fillimi i funksionimit të saj, kanë qenë të shumëllojshme duke theksuar edhe njëherë nevojën që kanë patur qytetarët për një sistem të tillë i cili deri më tani figuron të jetë mjaft rezultativ sidomos në kushtet kur në vend filloi ndërmarrja e masave kufizuese si pasojë e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga virusi (Covid-19).

Kjo platformë ka rezultuar mjaft e suksesshme pasi vihet re një numër i konsiderueshëm qytetarësh të cilët i janë drejtuar me qëllim marrjen e një orientimi ligjor mbi problematikat e tyre edhe pas përfundimit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore. ***Duke marrë në konsideratë natyrën e këtij shërbimi dhe duke qenë se qytetarët mund të parashtrojnë problematikën e tyre në këtë platformë thjesht përmes adresimit të një pyetjeje, pa qenë nevoja për të plotësuar të dhëna shtesë të përcaktuara në formularët për përfitimin e ndihmës juridike parësore, të dhënat statistike që mund të pasqyrojnë përkojnë vetëm me natyrën e çështjes (civile/penale apo administrative)***

RASTET E TRAJTUARA Mars 2023 (102)

50 Civile; 39 Administrative; 7 Penale; 6 Pa kategori

Numri i Gjelbër 08001010

Në funksion të masave të shtuara, të ndërmarra për qytetarët që kanë nevojë për shërbime të ndihmës juridike parësore, Ministria ka vendosur në dispozicion një linjë të gjelbër në të cilën kanë akses falas të gjithë qytetarët për shërbime të ndihmës juridike. Vendosja e një numri falas është një garanci më shumë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas duke siguruar për qytetarët disponibilitet në çdo kohë dhe përmes disa formave. ***Si platforma juristionline ashtu edhe linja e gjelbër janë masa të shtuara duke garantuar shërbime profesionale dhe me standard të lartë dhe duke qenë sa më pranë qytetarit. Nga të dhënat e administruara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas rezulton se qytetarët kanë shfaqur mjaft interes në përfitimin e këtij shërbimi ligjor gjë që përbën një hap mjaft pozitiv në kuadër të garantimit të aksesit në drejtësi për qytetarët.***

NUMRI I RASTEVE TË TRAJTUARA (Numri i gjelber 08001010)

TOTALI I RASTEVE (Telefonatave) 16


Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore




Totali i rasteve të trajtuara nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore për muajin Mars 2023

633 raste


Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas gjinisë)



**Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore
(sipas natyrës së çështjes)**



**Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore
(sipas kategorisë përfituese)**



Kategoritë e veçanta kryesore përfituese										
Lloji i ndihmës	Romë/ Egjiptian	Viktima Dhune	Viktima trafikimi	Persona me aftësi të kufizuar/ Verbër/ Probleme të shëndetit mendor	Të mitur viktimë/ në konflikt me ligjin	Viktima abuzimi seksual/ psikologjik	KMCAP	Ndihmë ekonomike	Skemat e mbrojtjes sociale	Pensionistë
<i>Ndihmë Juridike Parësore</i>	35	54	5	28	42	1	6	3	61	2

KREU 2: TË DHËNA STATISTIKORE MBI ÇËSHTJET ME OBJEKT NDIHMËN JURIDIKE DYTËSORE

1. Të dhëna statistikore: Sipas ndarjes gjinore, Gra dhe Burra.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Mars 2023, rezulton se për **53 vendime gjyqësore** në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike falas, **33** prej tyre rezultojnë për kërkuese gra, dhe **20** prej tyre për kërkuese burra. Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore mbi kërkuetit sipas ndarjes gjinore, Gra dhe Burra MARS 2023		
<i>Kategoria Gra / Burra</i>	<i>Numri i kërkuetve</i>	<i>Komente / të tjera</i>
Kërkuese Gra	33	<i>Në vijimësi të trendit të zakonshëm, kërkuetit e ndihmës juridike falas për muajin Mars 2023 janë më shumë gra se kërkuetit burra.</i>
Kërkuese Burra	20	
<u>TOTALI = 53 Vendime Gjyqësore</u>		

2. Të dhëna statistikore: Sipas kategorive përfituese, me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme / kategori e veçantë.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Mars 2023, rezulton se nga **53 vendime gjyqësore** në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike, **32** prej tyre rezultojnë për kërkuese që pretendojnë se i përkasin **kategorisë së personave me pasuri dhe të ardhura të pamjaftueshme**, **21** prej tyre rezultojnë nga kërkuese që bëjnë pjesë në **kategoritë e veçanta sipas ligjit**.

Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore mbi kërkuesit sipas kategorive përfituese MARS 2023			
<i>Kategoria përfituese</i>		<i>Numri i kërkuesve</i>	<i>Komente / të tjera</i>
Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme		32	1. Në vijimësi të trendit të zakonshëm, kërkuesit e ndihmës juridike falas për muajin Mars 2023 janë më shumë qytetarë që pretendojnë të jenë në kushtet e kategorisë së personave me pasuri dhe të ardhura të pamjaftueshme. 2. Ndërmjet kategorive të veçanta, kryeson me më shumë raste kategoria e personave me aftësi ndryshe/ statusi i të verbërit dhe viktimat e dhunës në familje.
E pa specifikuar në vendimin gjyqësor		0	
Kategori e veçantë (Total 21)	<i>Viktimë dhune / diskriminimi</i>	6	
	<i>Person me aftësi ndryshe / statusi i të verbërit</i>	8	
	<i>Përfitues nga skema e mbrojtjes sociale</i>	3	
	<i>Pensionistë</i>	4	
	<i>Komuniteti Rom</i>	0	
	<i>Statusi Jetim</i>	0	
TOTALI = 53 Vendime Gjyqësore			

3. Të dhëna statistikore: Lloji i ndihmës dytësore të kërkuar nga qytetarët.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Mars 2023, rezulton se nga **53 vendime** gjyqësore në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike, **1** prej tyre është kërkesë për dhënie e ndihmës juridike dytësore me avokat, **46** prej tyre janë kërkesa për dhënie e ndihmës juridike dytësore dhe përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore dhe **6** kërkesa për përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore. Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore mbi llojin e ndihmës dytësore të kërkuar MARS 2023		
<i>Lloji i ndihmës dytësore të ofruar</i>	<i>Numri i Përfituesve</i>	<i>Komente / të tjera</i>
Ndihmë juridike dytësore me avokat	1	Në analizë të së tërës, shihet që në pjesën më të madhe, kërkuesit kërkojnë ndihmën juridike dytësore dhe përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.
Ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	46	
Përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	6	
TOTALI = 53 Vendime Gjyqësore		

4. Të dhëna statistikore: Sipas vendimmarrjes së Gjykatave / Organit procedues për kërkesat.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Mars 2023, nga **53 vendime gjyqësore** në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike, rezulton se janë pranuar **47** kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, janë rrëzuar **2** kërkesa për përfitim nga ndihma juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, është pushuar **1** kërkesë për përfitim nga ndihma juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, është vendosur kthim aktesh për **1** kërkesë për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, është vendosur prishje vendimi dhe kthimin e çështjes për rigjykim për **1** kërkesë për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, si dhe është vendosur shpallje moskompetence për **1** kërkesë për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.

Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore vendimmarrjes së gjykatave ose organit procedues MARS 2023			
Lloji i ndihmës dytësore të ofruar	Vendimi i Gjykatës / Organit Procedues Pranim / rrëzim pranim pjesërisht	Numri i Kërkuesve	Komente / të tjera
Ndihmë juridike dytësore përfaqësim me avokat	Pranuar	1	1. Në vijimësi të trendit të zakonshëm evidentohet një numër i ulët i vendimeve që rrëzojnë kërkesën e ndihmës juridike. 2. Në analizë të së tërësi, nuk evidentohet raport i caktuar ndërmjet refuzimeve përsa i përket llojit të ndihmës juridike.
	Rrëzuar	0	
	Pushuar Çështja	0	
Ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	Pranuar	40	
	Rrëzuar	2	
	Pushuar Çështja	1	
	Kthim Aktesh	1	
	Prishje vendimi, kthim për rigjykim	1	
Përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	Shpallje moskompetence	1	
	Pranuar	6	
	Rrëzuar	0	
TOTALI = 53 Vendime Gjyqësore			

5. Të dhëna statistikore: Lloji i çështjes për të cilën kërkohet ndihmë juridike.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Mars 2023, rezulton se nga **53 vendime** gjyqësore në total me objekt kërkesën për ndihmën juridike, **47** prej tyre janë çështje civile, **4** janë çështje administrative, **1** është çështje penale dhe **1** është e papërcaktuar (N/A)

Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore sipas natyrës së çështjes gjyqësore që kërkohet ndihma MARS 2023		
Lloji i çështjes	Numri i kërkuesve	Komente / të tjera
Çështje civile (<i>pronësie, pjestim pasurie, vjetërsi pune</i>)	47	1. Në vijimësi të trendit të zakonshëm evidentohet që në pjesën dërrmuese ndihma juridike kërkohet për çështje civile. 2. Krahasimisht evidentohet një rritje e çështjeve administrative.
Penale	1	
Administrative	4	
N/A	1	
TOTALI = 53 Vendime Gjyqësore		

6. Të dhëna statistikore: Sipas gjykatave që ka dhënë vendimin.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Mars 2023, rezulton se nga **53 vendime gjyqësore** në total me objekt ndihmën juridike, **shumica i përkasin** Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe **një pjesë e vendimeve** është dhënë nga Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë.

Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore sipas gjykatave që kanë dhënë vendimin MARS 2023		
Gjykata që ka dhënë vendimin me objekt ndihmën juridike	Numri i vendimeve gjyqësore	Komente / të tjera
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Tiranë	1. Në vijimësi të trendit të zakonshëm, numri i vendimeve i përket në pjesën më
	Durrës	
	Elbasan	

	Fier	5	<i>dërmuese gjykatave të rrethit krahasimisht me gjykatat administrative.</i> <i>2. Të gjitha vendimet gjyqësore mbi kërkesat mbi ndihmën juridike janë përcjellë nga 12 gjykatat e rretheve gjyqësore.</i>
	Gjirokastrë	3	
	Krujë	1	
	Lezhë	12	
	Lushnje	2	
	Kavajë	1	
	Pogradec	2	
	Vlorë	4	
	Shkodër	1	
	Dibër	1	
	Kukës	0	
	Pukë	1	
	Kurbin	1	
	Korçë	1	
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë	Tiranë	1	
	Korçë	1	
	Vlorë	1	
Gjykata e Apelit	Tiranë	0	
	Vlorë	1	
<u>TOTALI =53 Vendime Gjyqësore</u>			

Kategoritë e veçanta kryesore përfituese										
Lloji i ndihmës	Romë/ Egjiptian	Viktima Dhune	Viktima trafikimi	Persona me aftësi të kufizuar/të verbër	Të mitur	Viktima abuzimi seksual	KMCAP	Ndihmë ekonomike	Skemat e mbrojtjes sociale	Pensionistë
<i>Ndihmë Juridike Dytësore</i>	0	6	6	5	0	0	3	0	3	4

KONKLUZIONE

Sa i përket Ndhmës Juridike parësore

- ✓ Nga rastet e administruara për muajin Mars 2023, në total rezultojnë 633 raste, nga të cilat 324 raste janë trajtuar nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore; 177 raste janë trajtuar nga Organizatat Jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë; 14 raste janë trajtuar nga Klinika e ligjit, që funksionon pranë ‘Universitetit Bedër’; 102 raste janë trajtuar nga Platforma juristionline.al si dhe 16 raste janë trajtuar përmes numrit të gjelbër 08001010.
- ✓ Sa i përket Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore qendrat me numrin më të lartë të rasteve të trajtuara janë: Qendra Gjirokastër, Fier, Tiranë dhe Shkodër. Qendrat që kanë nevojë për promovim të shtuar vijojnë të mbeten Qendra Berat dhe Dibër si dhe Qendrat e reja të Korçës dhe Kukësit të hapura rishtazi.
- ✓ Sa i përket organizatave jofitimprurëse të autorizuara, organizatat me numrin më të lartë të rasteve janë: TLAS dhe “Qendra për nisma ligjore qytetare”. Organizatat Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA) dhe Albanian Legal and Territorial Institute (ALTRI) nuk kanë pasur raste të trajtuara këtë muaj; Nuk kanë raportuar organizatat si vijon: Qendra e Gruas “Hapa të lehtë” dhe Refleksione.
- ✓ Nga analiza e të dhënave konstatohet se pjesa më e madhe e rasteve të trajtuara janë të natyrës administrative (54%) pasuar nga çështjet civile (41%) dhe çështjet penale (5%). Numri më i madh i përfituesve sipas gjinisë rezultojnë të jenë femra (60%) pasuar nga meshkujt (40%).
- ✓ Nga analiza e të dhënave konstatohet se ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore kanë trajtuar një numër të konsiderueshëm të rasteve ku përfitues janë kategoritë në pamundësi financiare (60%) si dhe kategoritë e veçanta përfituese (34%) .

Sa i përket Ndhmës Juridike Dytësore

Nga vendimet gjyqësore me objekt ndihmën juridike falas, të administruara nga DNJF për muajin Mars 2023, në total rezultojnë 53 vendime gjyqësore nga të cilat në 47 vendime janë pranuar kërkesat për ndihmë juridike dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, 2 vendime janë rrëzuar kërkesat për ndihmë juridike dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, 1 vendim për pushimin e çështjes mbi kërkesën për përfitim nga ndihma juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, 1 vendim për kthim aktesh mbi kërkesën për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, 1 vendim për prishje vendimi dhe kthimin e

çështjes për rigjykim mbi kërkesën për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, si dhe **1 vendim shpallje moskompetence** mbi kërkesën për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.

- ✓ **Lidhur me** kategorinë përfituese nga shërbimi i ndihmës juridike, numrin më të madh të cilëve e përbën gjinia femërore (*33 përfitues femra dhe 20 përfitues meshkuj*).
- ✓ Numrin më të madh të vendimeve e përbëjnë çështjet civile (*pronësie, pjestim pasurie, heqje zotësie për të vepruar, vjetërsi pune, caktim kujdestarie*)
- ✓ **Lidhur me Gjykatat që kanë dhënë vendimet me objekt ndihmën juridike** dytësore dhe / ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, rezulton se: për muajin Mars 2023, **numrin më të madh të vendimeve e ka dhënë dhënë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë**, e pasuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Fier.

- Numri i vendimeve gjyqësore të ankimuara nga DNJF për muajin Mars 2023: **1**
- Numri i vendimeve gjyqësore të pranuar nga DNJF për muajin Mars 2023: **56**
- Numri i ankimeve të pranuar nga gjykata e apelit për muajin Mars 2023: **2**
- Kërkesa për ndihmë juridike dytësore të rrëzuar apo të pushuar nga gjykata për muajin Mars 2023: **1** kërkesë ku është vendosur kthim aktesh, **1** kërkesë është vendosur moskompetencë dhe **2** kërkesa të rrëzuara.
- Kërkesë për ndreqje gabimi të depozituar në gjykatë për muajin Mars 2023: **0** kërkesa.
- Kërkesa për ndreqje gabimi të pranuar nga gjykata për muajin Mars 2023: **0** kërkesa.
- Kërkesa për ndreqje gabimi rrëzuar nga gjykata për muajin Mars 2023: **1** kërkesë.
- Numri i dosjeve avokatë/ekspertë të pranuar për ekzekutim pagese për muajin Mars 2023: **25** dosje.
- Numri i dosjeve avokatë/ekspertë të refuzuara për ekzekutim pagese për muajin Mars 2023: **2** dosje

INFORMACION MBI PAGESAT E PËRFAQËSIMIT TË AVOKATËVE TË NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE SI DHE SHPENZIMET GJYQËSORE TË LIKUJDUARA

2023						
Kategori	Vlerë			Sasi		
Muaji	Avokatë	Ekspertë	Gjykata	Avokatë	Ekspertë	Gjykata
Janar	110,500	80,000	0	4	2	0
Shkurt	369,500	240,000	0	12	6	0
Mars	805,000	280,000		23	7	0
TOTAL	1,285,000	600,000	0	39	15	0

- Në total gjatë muajit **Mars 2023 janë likujduar 30 vendime gjyqësore me vlerë totale prej 1,085,000 lekë.**
- Në total për periudhën **Janar – Mars 2023 janë likujduar 54 vendime gjyqësore me vlerë totale prej 1,885,000 lekë.**

Konkluzione

NDIHMA JURIDIKE PARËSORE JANAR- DHJETOR 2023

Muaji	Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore	Organizatrat jofitimprurëse të autorizuara	Klinikat e Ligjit pranë IAL	Platforma juristonline	Numri i gjelbër	Total
Janar	305	235	0	111	21	672
Shkurt	295	251	0	87	16	649
Mars	324	177	14	102	16	633
Prill						
Maj						
Qershor						
Korrik						
Gusht						
Shtator						
Tetor						
Nentor						
Dhjetor						
Total	924	663	14	300	53	1954

Total Ndhma Juridike Parësore: 1954 raste të raportuara

NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE JANAR- DHJETOR 2023

<i>Vendime Gjyqësore me Objekt Ndhmën Juridike JANAR – DHJETOR 2023</i>	
<i>Totali i Vendimeve Gjyqësore = 187</i>	
Janar	64
Shkurt	70
Mars	53
Prill	
Maj	
Qershor	
Korrik	
Gusht	
Shtator	
Tetor	
Nentor	
Total	187

Të dhënat statistikore për vitin 2023 (Sipas kategorive të veçanta kryesore përfituese)

Lloji i ndihmës	Romë/Egjiptian	Viktima Dhune	Viktima trafikimi	PAK	Të mitur	Nr. Total
<i>Ndihmë Juridike Parësore</i>	109	195	21	95	124	544
<i>Ndihmë Juridike Dytësore</i>	-	31	-	22	1	54

Lloji i ndihmës	Kategoritë pa të ardhura dhe pasuri	Kategoritë e vecanta	Nr. Total i rasteve për të gjithë qytetarët përfitues
<i>Ndihmë Juridike Parësore</i>	944	384	1328 (duke përfshirë nr e gjelbër dhe platformën juristonline)
<i>Ndihmë Juridike Dytësore</i>	96	91	187

Lloji i ndihmës	Meshkuj	Femra	Nr. Total i rasteve për të gjithë qytetarët përfitues
<i>Ndihmë Juridike Parësore</i>	643	1025	1668 (duke përfshirë nr e gjelbër dhe platformën juristonline)
<i>Ndihmë Juridike Dytësore</i>	64	123	187